

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“ZENINA” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 91, pika 1, dhe 92, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1844/11, datë 13.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Zenina’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Zenina” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1844 prot., datë 30.8.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 186, datë 12.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.9.2024 dhe 14.9.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.9.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1927, datë 16.9.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë (ku me shkresën nr. 1844/4 prot., datë 30.9.2024, ERE e ka njoftuar atë për vendimin nr. 186/2024 dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e të munguar të këtij aplikimi dhe shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues), me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1844/5 prot., datë 9.10.2024, ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 14.10.2024, është vendosur zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Shoqëria në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar për këtë aplikim, ka kthyer përgjigje me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1844/8 prot., datë 11.11.2024 dhe nr. 1844/10 prot., datë 13.11.2024.

- Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se shoqëria ka dokumentuar kryerjen e aplikimit për pajisje me VNM Paraprake të re më datë 6.11.2024. Gjithashtu, rezulton se nevojitet të sqarohet me tej me shoqërinë dokumentacioni takues që duhet të depozitohet për vlerën e mbetur të investimit të projektit.

- Në nenin 91, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet si vijon: *Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.* Në lidhje me zgjatjen e afateve procedurale të një procedure administrative, në nenin 92, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon si vijon: *Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.*

- Për sa më lart, vlerësojmë se në rrethanat e një aplikimi të ri për VNM-në dhe pritjes së miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe për të sqaruar dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim, vlerësojmë zgjatjen deri më datë 26.1.2025 të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Zenina” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke filluar ky afat nga data e aplikimit të shoqërisë për VNM-në paraprake, më datë 6.11.2024.

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri më datë 26.1.2025 afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Zenina” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE, VNM paraprake të re dhe dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare deri më datë 16.1.2025.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Zenina” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti